

URDHËR
Nr. 179, datë 19.9.2024

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Bazuar në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; në nenet 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe në pikën 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin te Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Brendshme të kompetencave funksionale si vijon:

- Nënshkrimin e kontratave të punës për pozicionet e punës që rregullohen me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, si dhe kryerjen e të gjitha veprimeve administrative dhe procedurale në zbatim të tyre.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha